




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No
<u>DPK</u>	<u>03-02/1799/18</u>
Nr. flet Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
<u>02</u>	<u>29.06.2018</u>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.06.2018, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-822/18, për znj. Burbuqe Berisha, ish Anëtare e Bordit në Teatrin Kombëtar të Kosovës, për shkak se zyrtarja e lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit, duke dhënë dorëheqje nga funksioni publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë, znj. Burbuqe Berisha, ish Anëtare e Bordit në Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe njëkohësisht U.D. Dekane në Fakultetin e Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtaren e lartë znj. Burbuqe Berisha me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese është organizuar një takim me zyrtaren e lartë. Gjatë këtij takimi zyrtarja e lartë është njoftuar se krahas ushtrimit të funksionit Anëtare e Bordit në Teatrin Kombëtar të Kosovës nuk mund të ushtroj njëkohësisht edhe funksionin U.D. Dekane në Fakultetin e Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB sepse kjo situatë është në kundërshtim me



nenin 13 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në të cilën thuhet:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Gjatë procedurës së zhvillimit për konflikt interesi, Agjencia i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtares së lartë, me të cilën asaj i është kërkuar të heq dorë nga njëri funksion brenda afatit ligjore, përndryshe Agjencia është e obliguar të veproj konform nenit 22 paragrafi 8 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI.03-02/1625/18) me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë znj. Burbuqe Berisha ka dhënë dorëheqje nga funksioni Anëtare e Bordit në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

